



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Sh II.nr. 1526/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë rr. “UÇK” nr.2, kundër debitorit “Kastrati Pharm” SH.P.K, me numër të regjistrimit të biznesit 71338053, me seli në Prishtinë, rr. “Enver Maloku” nr. 116. duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2098/23 të datës 28.06.2024, me datë 25.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 2098/23 i datës 28.06.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës– Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 2098/23 të datës 28.06.2024, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Kastrati Pharm” SH.P.K., dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr. 438/23 i datës 17.08.2023 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të cënimit thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, duke propozuar që aprovohet si e

bazuar ankesa e Kreditorit, te ndryshohet aktvendimi i atakuar, dhe te refuzohet prapësimi i debitorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna e Prishtinës, ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit "Kastrati Pharm" SH.P.K, me numër të regjistrimit të biznesit 71338053, me seli në Prishtinë, rr. "Enver Maloku" nr. 116, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.201912707 datës 19.12.2022,

Përmbartuesi privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.438/23 dt.17.08.2023 ka lejuar përmbartimin, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në afat prej 7 ditësh t' ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 1,500.00€, si dhe shpenzimet e procedurës nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit, dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr. 438/23 i datës 17.08.2023 të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar bazuar në faturën nr.201912707 dt.19.12.2022, në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbartim, e njëjta nuk është pranuar nga debitorin, dhe rrjedhimisht propozimi për përmbartim është paraqitur në kundërshtim me nenin 29, paragrafi 1 i LPP-së. Rrjedhimisht, fatura si e tillë rezulton të jetë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditorin, andaj edhe nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga

neni 182 paragrafi 2, të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbareme me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Fillimisht propozimi për përmbareme është ushtruar në bazë të faturës e cila nuk i përmban tiparet e faturës së rregullt, pasi që e njëjta nuk përmban nënshkrimin apo vulën e debitorit, dhe rrjedhimisht rezulton se e njëjta nuk është pranuar me rregull nga debitorit dhe bazuar në nenin 29.3 të LPP-së, nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm në procedurë përmbareme.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbareme, respektivisht është lejuar përmbaremi, nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura nuk është pranuar nga ana e debitorit.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimit, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbareme.

Përndryshe, në procedurën përmbareme konform parimit të rigorozitetit formal, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbaremi i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e Organit Përmbaremi që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbaremin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.1526/24 datë 25.11.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha